



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

Nr _____ Prot

Kukës më ____ . ____ . 2023

Lënda: Dërgim i Raport i prioriteteve, kërkesave e rekomandimeve të dala nga seancat konsultative me publikun.

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë Kukës

Për dijëni: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak

Këshilli Bashkiak Kukës, bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), nenet 3/ç, 3/dh, 16/1, 18/1, 18/2, 19, 54/dh, 54/f, 57/2/d, Vendimin Nr. 22, datë 25.02.2020 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak”, nenet 53, 129, 131, 132, 152, 153, 161, Ligjin Nr. 146/2014 “ Për njoftimin dhe konsultimin publik” nent 6 dhe 7, ka zhvilluar seancat e konsultimit me publikun lidhur me projektvendimet:

- 1.Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kukës për vitin 2024.
- 2.Për miratimin e PBA-së 2024-2026
- 3.Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024.

Bashkëngjitur kësaj shkrese po ju dërgojmë raportin përfundimtar të prioriteteve, kërkesave dhe rekomandimeve të qytetarëve, të nxjerra nga këto seanca konsultimi.

Faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI

Albert MUJA

RAPORT I PRIORITETEVE KËRKESAVE E REKOMANDIMEVE TË DËGJESAVE PUBLIKE

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), nenet 3/ç, 3/dh, 16/1, 18/1, 18/2, 19, 54/dh, 54/f, 57/2/d, Vendimin Nr. 22, datë 25.02.2020 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak”, nenet 53, 129, 131, 132, 152, 153, 161, Ligjin Nr. 146/2014 “ Për njoftimin dhe konsultimin publik” nent 6 dhe 7, VKB – së nr. 83 datë 23.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës për vitin 2023” si dhe VKB – së nr. 81 datë 23.12.2022 “Per miratimin e Kalendarit te aktiviteteteve të Programit Buxhetor Afat-Mesëm (PBA) për vitet 2024-2026 dhe të buxhetit vjetor 2024”, Këshilli i Bashkisë Kukës dhe Sekretariati i Këshillit Bashkiak Kukës në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtorinë e Të ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Liçencave, organizuan konsultimet publike:

Titujt e projekt akteve të këshilluara:

Projektvendim i Këshillit Bashkiak nr.50 date 11.12.2023 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Kukës për vitin 2024”

Projektvendim i Këshillit Bashkiak nr.51 date 11.12.2023 “Për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”

Projektvendim i Këshillit Bashkiak nr. 46 datë 04.12.2023 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës, për vitin 2024”

Koha dhe vendi i zhvillimit të konsultimeve:

Nr	Dita	Ora	Data	Vendi
1	E Hënë	10 ⁰⁰	11.12.2023	Bushtricë, Ndërtesa e ish komunës Bushtricë.
2	E Hënë	13 ⁰⁰	11.12.2023	Bicaj, Shtëpia e kulturës Bicaj.
3	E Martë	10 ⁰⁰	12.12.2023	Shishtavec, Lokal “Skiatori”, Pika doganore Shishtavec
4	E Martë	14 ⁰⁰	12.12.2023	Kolsh, Shkolla 9-vjeçare Kolsh.
5	E Mërkure	11 ⁰⁰	13.12.2023	Kukës, Pallati i Kulturës “Hasan Prishtina” Kukës.

Metodat e konsultimit:

Marrja e opinionëve dhe mendimeve direkt nga të pranishmit në konsultimin publik, nëpërmjet diskutimeve, pyetjeve, propozimeve dhe rekomandimeve, paraqitja e konkluzioneve në komisionet përkatëse dhe në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Kukës.

Grupet e interesit të përfshira në konsultim:

Kryetari i Këshillit, zv Kryetarët e Këshillit Bashkiak Sekretariati i Këshillit Bashkiak Kukës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria e Të ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Liçencave, Drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit Programeve, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, Drejtues të njësive Administrative, Specialistë dhe inspektorë të zonës që punojnë për llogari të institucioneve qendrore, rajonale dhe vendore, mësues agronom, mjekë, Kryepleq dhe anëtarë pleqësie të fshatrave, përfaqësues të shoqërisë civile , organizatave jofitimprurëse, medias dhe biznesit, bujq, blegëtorë dhe minatorë, banorë të fshatrave të zonës.

Çështjet e adresuara në konsultim:

A keni ju ndonjë rekomandim konkret tuajin apo të komunitetit që përfaqësoni, për prioritetet e investimeve kapitale për vitet 2024-2026?

A jeni ju të informuar mbi taksat dhe tarifatat që mblihen në territorin e Bashkisë Kukës, cili është mendimi juaj për ndryshimin e nivelit të ndonjëres nga këto taksa apo tarifa?

Komentet e bëra në konsultim, i paraqiten kryetarit të bashkisë, komisionit të ekonomisë e financës dhe anëtarëve të këshillit bashkiak.

Në takimin e zhvilluar ditën e hënë me datë 11.12.2023 ora 10⁰⁰, në Bushtricë, në oborrin e ndërtesës së ish komunës Bushtricë, morën pjesë rreth 50 banorë të Njësive Administrative Bushtricë, Kalis, Grykë-Çajë dhe Ujmisht,

Administratorët e këtyre njësive, kryepleq etj., pas diskutimeve të Kryetarit të Këshillit të Bashkisë dhe prezantimit nga Drejtoria e Të ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Liçencave dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për çështjet e adresuara në konsultim, u morën këto opinione:

Banor1: Rruga e makinës, mirëmbajtja e saj.

Banor2: Rrugët kanë nevojë të mirëmbahen dhe duhen 2 punëtorë mirëmbajtje.

Banor3: Rruga e fshatit Vilë, linja e transportimit të fëmijëve është deri në Voren dhe nuk vjen në Vilë. Të rregullohet rruga Voren –Vilë.

Banor4: Ura e Drazhve rrezikon jetën e banorëve të lagjes.

Banor5: Duhet politika ekonomike që të mos bjere popullsia e zonës pasi është në rënje. Terrenet sportive të shkollave dhe ndriçimi e sistemimi i qendërs së ish-komunës Ujmisht.

Banor6: I kemi dorëzuar me shkrim problemet dhe shqetësimet tona.

Rrethimi i varrezave te fshatit Gjegje

Rikonstruksioni i Ujësjiellësi i fshatit Gjegje

Zbërthimi i studimit gjeologjik për shtëpitë e Hamdi Palushit, pasi janë 5 kurorë në një shtëpi.

Administrator Njesisë Administrative Grykë-Çajë, shkollat Buzmadhe, Shkinak, Çajë dhe ndërtesa e Njesisë Administrative Grykë-Çajë, ndihma financiare për 20 nxënësit e shkollës së mesme.

Kalis, Rruga Gështenjë-Kalis mirëmbajtje dhe skorje për borën dhe akullin, rrugë lidhëse me Hydrocentralin. Sot që po flasim, kjo rrugë është në gjendje të mjerueshme. Hydrocentrali që ushtron aktivitetin ka detyrime ndaj zonës.

Banor7:- Kam problemin e transportit të fëmijës për në shkollë. Fëmija im udhëton i vetëm për të ndjekur mësimet në Bushtricë.

Banor tjetër8: Si bëhen mësimet kur janë bashkuar klasat (2-5) (1-4). Si mund të mësojnë fëmijët në të tilla kushte?

Banor9: Fond të veçantë si njësi administrative për emergjencat civile. Na siguroni mundësinë për pastrimin e rrugëve.

Në takimin e zhvilluar ditën e hënë me datë 11.12.2023 ora 13⁰⁰, në Bicaj, në Shtëpinë e kulturës Bicaj, morën pjesë rreth 40 banorë të Njesisë Administrative Bicaj, Administratori i kësaj njësie, kryepjeq etj.

Pas diskutimeve të Kryetarit të Këshillit të Bashkisë dhe prezantimit nga Drejtoria e Të ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Liçencave dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për çështjet e adresuara në konsultim, u morën këto opinione:

Banor: ngre problemin e vonësës së ndihmës ekonomike (6%) pasi është njeri i vetmuar dhe pa të ardhura.

Banor: anëtar i pleqësisë fshatit Nangë, pyet nëse ka buxhet të ndarë për fshatin Nangë dhe ngre shqetësimin për rrugën e varrezave të fshatit dhe rrugën e Lapidar i Kuq -Krenzës.

Banor: Shkolla e nisur për t'u ndërtuar dhe e papërfunduar (e braktisur) në lagjen e Re, në një kohë kur shkolla 1 Qershori nuk i plotëson kushtet për të qenë shkollë.

Banor: Duhet që problemi i vaditjes nuk duhet të lihet pas dore, si dhe kontrolli i cilësisë së investimeve të jetë më i mirë. Pse të bëhet disa herë investim për të njëjtën gjë, kur mund të bëhet vetëm 1 herë e me cilësi të lartë.

Banor (kryeplak i fshatit Nangë): Kanalet e ujrave të zeza, kanali i vaditjes dhe shkolla e Bushatit janë problemet tona kryesore. Kanali përgjatë rrugës nacionale është bllokuar.

Kanali vaditës I Bicajve dhe Nangëve është rrafshuar komplet. Duhet vënë dorë.

Kryeplak i fshatit Bushat: Kanalet e ujrave të zeza, shkolla e Bushatit.

Banor, kryeplak i fshatit Gabrricë: Rruga e fshatit Gabrricë është 7 km dhe ne kërkojmë një mirëmbajtës për të.

Banor: Kopshti i fëmijëve, rruga e Lakut e Bjeshkës, uji i pishëm (ka kohë që është lidhur një tub por nuk vihet në funksion), mirëmbajtja e rrugëve. Këto gjëra janë jetike për banorët. Janë arsytet që po I largojnë njerëzit nga fshati.

Banor kryeplak i fshatit Osmane: A është shpërndarë buxheti sipas fshatrave? Problem janë rrugët e brendëshme të fshatit dhe vaditja, kur çdo banor paguan nga 8200 lekë për ujin.

Banor kryeplak i fshatit Mustafaj: Kam Vendimin e Këshillit Bashkiak për rrugën e fshatit Mustafaj, prandaj shtrova pyetjen se kur do të bëhet financimi. Është 1 km rrugë që përdoret nga 229 nxënës, 22 mësues dhe shumë pensionistë.

Banor: Problem është depoja e ujit të pishëm dhe rrugët e brendëshme të fshatrave të Njësisë Administrative Bicaj (rrugicat e papërfunduara).

Në takimin e zhvilluar ditën e martë me datë 12.12.2023 ora 10⁰⁰, në Shishtavec, në Lokal "Skiatori", Pika doganore Shishtavec., morën pjesë rreth 30-40 banorë të Njësisë Administrative Shishtavec, Zapod, Topojan, Administratorët e këtyre njësisë, kryepleq etj.

Pas diskutimeve të Kryetarit të Këshillit të Bashkisë dhe prezantimit nga Drejtoria e Të ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Liçencave dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për çështjet e adresuara në konsultim, u morën këto opinione:

Banor: Dy urat që kanë nevojë për vendosjen e tombinove dhe lidhin stanet me fshatin Novosej, janë jashtë funksionit dhe po rrezikojnë kështu jetët e fëmijëve që vazhdojnë shkollën.

Banor: Nëse nuk zgjidhet problem i urave ne si banorë do të ndalojmë fëmijët për vazhdimin e mësimit dhe do të njoftojmë emisionet STOP dhe FIKS FARE. Është problem shumë emergjent. Rrezikohet jeta e fëmijëve tanë.

Banor: A është planifikuar rikonstruksioni apo ndërtimi i zyrave të Komunës Shishtavec, pasi ka 9 vjet që paguhet qera për zyra të Njësisë Administrative.

Fshati Zapod: Rrugët pa asfalt, të sigurohet mirëmbajtës rruge, nevojë për ndërhyrje në ujësjellës. Rruga Orcikël- Zapod është e bllokuar.

S. M: Do të flas si banor i kësaj zone dhe jo si Anëtar Këshilli, prandaj dua të di nëse ka projekt konkret për fshatin Novosej për vitin 2024.

Banor: Të ardhurat që mblidhen nga HEC-et pse nuk shkojnë në zhvillimin infrastrukturor të komunitetit ku është ndërtuar HEC-i, unë mendoj që 40% e këtyre të ardhurave të përdoret për komunitetin ku është ndërtuar HEC-i.

Banor: Prioriteti për vitin 2024, bën fjalë për rrugët e brendëshme të fshatit Topojan apo për rrugën e Brekisë.

Banor; Kam ankesë për firmën që ka bërë punimet në Shishtavec. Kur bie shi rrugët mbyten nga uji. Duhet të ishin bërë disa zgara.

Banor; Të bëhet ndërhyrje në ujësjellës e kanalizime.

Në takimin e zhvilluar ditën e martë me datë 12.12.2023 ora 14⁰⁰, te shkolla 9 vjecare në Kolsh, morën pjesë rreth 40-50 banorë të Njësive Administrative Kolsh, Malzi, Surroj, Arrën. Administratorët e këtyre njësive, kryepleq etj.

Pas diskutimeve të Kryetarit të Këshillit të Bashkisë dhe prezantimit nga Drejtoria e Të ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Liçencave dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për çështjet e adresuara në konsultim, u morën këto opinione:

Banor, banor i Arrnit: Ka 33 vite që në Arrën nuk është vënë dorë. Ne nuk duam asfalt, kërkojmë minimumin, rrugë me kalldrëm. Nuk kemi as kabinë elektrike, as ujë. Nuk kemi asnjë shërbim. Kërkojmë ujë, drita, arsim, shëndetësi.

Banor (kryeplak i fshatit Mamëz): Rruga është katrahurë, kur do të fillojë ndërtimi i kësaj rruge? Mbeturinat në Mamëz digjen dhe shkaktojnë ndotje në mjedis, në njerëz, në bletë. Këto probleme ekzistojnë. Në fshatin tonë është bërë vetëm ambulance. Po bëhet një xhami. Shteti duhet të verë dorë. Të paktën të sigurohet një punëtor për mirëmbajtjen e rrugëve.

Banor (Arrën): Për fshatin tonë nuk është marrë asnjë veprim. Ne kemi nevoja si komunitet. Firma Dobrushki merr e shfrytëzon mineralin dhe nuk bën asgjë për komunitetin, përveçse ka dëmtuar rrugët e kanalet. Ka 33 vjet që jemi të gënjyer. Nuk kemi as rrugë e as shërbime.

Banor (Kolsh): Kemi probleme me furnizimin me energji elektrike. Kanë vënë një transformator i cili ende nuk është vënë në punë. Uji shkon kot dhe ne nuk kemi ujë nëpër shtëpitë tona. Qendra Shëndetësore gati po shembet. Lidhur me taksat, mendoj se 800 mijë lekë taksë pastrami është shumë e lartë (kam biznes të vogël).

Fshati Kolsh: -Pse na sillni punonjës nga Kukësi kur mund të punësohen të rinjtë e Kolshit?

Kemi probleme me furnizimin me ujë, duhet të rregullohet ujësjellësi.

Banor(Malzi)- Prioritet kryesor kemi rrugët. Ka rrugë që lidhin 2-3 fshatra. Ne si njësi kemi një mendim: Të bëhet ndërhyrje me mjete dhe punonjës për mirëmbajtje. Gjithashtu ujësjellësi është në gjendje të mjerueshme. Duhet të bëhet ndërhyrje.

Banor (Arrën): Ndërhyrje në rrugën e makinës (200 m) dhe shkollë pasi nuk kemi fare.

Banor (Kolsh): Ne në lagjen Çikaj kemi hapur një rrugë privatisht. Asnjë investim nga bashkia nuk kemi marrë. Sillni të paktën një makineri për sheshim e rregullim.

Banor i fshatit Kolsh: Nuk është ndërtuar asgjë te ne. As tel e as kabull nuk është ndërruar. Ne jemi pa drita vetëm një erë kur fryn.

Banor (Surroj): Projektbuxheti nuk është I ndarë për njësi. Ne duam të dimë çfarë ka për njësinë tonë. Rruga e Surrojit është bërë legjendë. Asnjë milimetër nuk është bërë. Gjithashtu, nuk bëhet fare promovim I turizmit për këto zona. Janë resurse të mrekullueshme. Mund të bëhet plazh, kampingje verore.

Shkolla jonë është mbyllur për shkak të kushteve sepse çfarë binte jashtë, futej brenda.

Banor (Malzi): Rrugët janë në gjendje të mjerueshme. Jemi komuniteti që kontribuojmë më së shumti me taksa. Pse nuk na kthehen në shërbime? Ti kthehen shërbime komunitetit të Shëmbisë, Malziut.

Banor i Kolshit. Kemi problemin e mbeturinave (as kosh, as transport për t'i hequr).

Banor tjetër: - Papunësia është problemi ynë kryesor. Nuk punësohemi ne por vijnë punëtorë nga larg. Këtu po vidhet dhe ne nuk shohim asgjë. Salillari, minierat shfrytëzojnë zonën tonë duke marrë punëtorë anës e anës e djemtë tanë rrinë në shtëpi kur kanë diploma e të gjitha.

Banor tjetër (Kolsh): Është caktu një dokoreshë. Kurrë nuk vjen. Vijnë vetëm infermieret por jo dokoresha. Punësohen infermierë sezonalë. Ne nuk sëmuremi me sezone. Ky është turp i madh. Myc-Mamëz: Mbeturinat nuk pastrohen asnjëherë. Nuk ka ardhur kurrë makineria. Elektri i Lagjia Oruç dhe Istref janë të lidhura me rrjetin e qytetit. Të bëhet dhe lagjia Spahia.

Në takimin e zhvilluar ditën e martë me datë 13.12.2023 ora 11⁰⁰, te pallati i kulturës "Hasan Prishtina", morën pjesë rreth 30-40 banorë të Kukësit dhe njësisë administrative Shtiqën e Tërthore, kryepleq, përfaqësues të njësisë administrative, anëtarë të Këshillit Bshkiak

Pas diskutimeve të Kryetarit të Këshillit të Bashkisë dhe prezantimit nga Drejtoria e Të ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Liçencave dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për çështjet e adresuara në konsultim, u morën këto opinione:

A.G: Ka ulje të taksave?

Kryetar i fshatit Gjalicë:- Kemi emergjente kanalizimet, sistemimin e ujërave të zeza. Gjithashtu një rrugë 800 m që lidh fshatin me urën 6 metroshe. Kjo rrugë është vetëm për asfaltim.

Njësia administrative Shtiqën: Problematikat kryesore janë kanalizimet, 3 rrugët (Krenzë, Stacion- Aeroport dhe rruga për te ura 6 metroshe), godina e njësisë administrative ka nevojë për investim (ish-komuna), kanali i vjetër vaditës, ndricimi në fshatra, mirëmbajtja e rrugëve.

Banor tjetër i Shtiqnit: Rruga e FSHN-së dhe kanali vaditës i Malit të Beqës.

Banor (Krenzë): I kemi të gjitha por nuk kemi rrugë.

Banor (Kodër- Lumë)- Janë mbi 120 nxënës në fshatin tonë. Për shkak të kushteve të këqija të shkollës, kanë mbetur vetëm 2 klasa që bëjnë mësim aty. Pjesa tjetër e fëmijëve detyrohet të vijë në Kukës. Edhe ambulance është mbyllur. Sa i përket taksave, si veprohet për familjet në nevojë.

Banor: Ne si njësi kemi 6 km rrugë. Duhet mirëmbajtje e tyre dhe ndërhyrje. Duhet të vihet në lëvizje puna për kanalizimet.

Shkolla Elmaz Ademi ka nevojë për ndërhyrje.

Kopshti Gjegan kërkon ndërhyrje emergjente (nuk kanë as drita dhe pikon uji).

Breg-Lumë, shkolla ka nevojë për pak ndërhyrje. Ende në zonën tonë mbushim ujë me bidona. Ujësjellësi është jashtë shërbimit. Duhet ndërhyrje.

R. T: Punimet që po bëhen në qytet nga ujësjellësi, a mbikëqyren? Punimet janë shumë të këqija dhe kanë sjellë shqetësime e probleme te banorët.

B. O: Ju përgëzoj për realizimin e dëgjësive publike për njësi. Këtu kemi qytetarë të thjeshtë, kryetarë fshatrash dhe kjo është shumë gjë e mirë. Në lidhje me taksat e tarifave: A ka mundësi të gjejmë mënyrën që ata që po na shfrytëzojnë pasuritë natyrore, të kontribuojnë me investime e shërbime në komunitet? Duhet të kërkohet zbatimi i paktit social. Lidhur me tarifën e mbetjeve, kërkoj bashkëpunim për përlllogaritjen e mbetjeve për person dhe familje. Është dicka që mund të bëhet.

Sic vërehet, problematikat kryesore të banorëve janë në infrastrukturë, mirëmbajtje e rrugëve rurale, furnizim me ujë dhe energji elektrike, arsim, shëndetësi, shërbime publike, etj. Duke i marrë në konsideratë kërkesat, shqetësimet dhe nevojat e komunitetit, mund t'i grupojmë si më poshtë:

FUNKSIONE TË VETË QEVERISJES VENDORE

1. Rrjeti Rrugor Rural Mirëmbajtje e rrugëve në njësinë administrative Ujmisht (hapje e rrugës Brukë –Selim, rruga e fshatit Zall-Lusën, rruga e lagjes Gjete, rruga e lagjes Peposhe, rruga e lagjes Loke-Gjane) mirëmbajtjen e rrugëve fshati Grykë-Çajë, ndërtimi i rrugës Voren-Vilë (për shkak të dëmtimit të rrugës është penguar transporti i fëmijëve me furgon), hapja e rrugës Gështenjë-Kalis, mirëmbajtja e rrugës në fshatin Bushtricë, riparimin e urës në fshatin Bushtricë e cila kushtuar rreth 8 milion lekë (të bëhet ndërhyrje për riparimin e saj që dëmtimi të mos shkojë në atë shkallë që ura të bëhet nga e para), sistemim e asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit

Nangë, sistemim e asfaltim i rrugëve të brendshme të fshatit Osmanaj, asfaltimi i rrugës “Mustafaj” me gjatësi 1 km e cila përdoret nga 229 nxënës, 22 mësues dhe pensionistë, ndërtimi i rrugës Bjeshkës (Lakut të Dardhës), mirëmbajtje e rrugës së fshatit Mholaj, mirëmbajtje e rrugës në fshatin Gabricë, ndërhyrje në rrugën Lapidari- Varrezat në fshatin Nangë, mirëmbajtje rruge fshati Zapod, hapje e rrugës Orçikël-Zapod pasi është e bllokuar, mirëmbajtja e rrugës Ura e Koloshit- Orgjost- Zapod, restaurimi urës së Orgjosit (është problematikë e studiuar nga drejtoria e emergjencave civile te bashkise dhe ka një project për këtë urë), ndërhyrje në rrugën Pika Kufitare Borje- Fshati Borje dhe rehabilitim i mureve mbështetëse në rrugën kryesore të fshatit Borje (këto mure përbëjnë rrezik për jetën e banorëve që kanë shtëpinë afër), rehabilitimi i rrugës hyrëse në fshatin Borje , rikonstrukcion i rrugës në fshatin Novosej pasi ka kohë që është në listën e prioriteteve, rrugë të brendshme të fshatit Novosej, rruga e fshatit Brekijë, shtrim i rrugëve me kalldrëm në Arrën pasi nuk është vënë dorë asnjëherë, ndërtimi i rrugës së Surroit, shtrim i rrugës në fshatin Mamëz, ndërhyrje në sistemimin e rrugëve, mjete dhe punonjës për mirëmbajtje në rrugët e njësisë Malzi, sheshim dhe rregullim i një rruge në lagjen Çikaj (Kolsh) e cila është hapur privatisht me kontributin e banorëve të fshatit, asfaltimi i një rrugës që lidh fshatin Gjalicë me urën 6-metroshe, mirëmbajtja e rrugëve në njësia administrative Shtiqën, Rruga e fshatit Krenzë, ndërhyrje në rrugët e njësisë administrative Tërthore.

2. Arsimi (parashkollor, bazë dhe i mesëm) Ndërhyrje në shkollën 9-vjeçare “Sali Bruka” Malqene dhe shkollës Lusën (çatia, terrenet sportive, furnizimi me material pastrami dhe ngrohje), Ndërhyrje në shkollat e fshatit Buzmadhe, Shkinak e Çajë (rrethimi dhe tualetet), Hapjen e kopshtit për 12 fëmijë në fshatin Shkinak, punësimi i një edukatoreje, Ndërhyrje në shkollën 9- vjeçare Bushat, Mungesa e shkollës, njësia Arrën, Ndërhyrje në shkollën e fshatit Kodër-Lumë ku janë aktualisht rreth 120 nxënës(pjesa më e madhe e tyre vijnë e bëjnë mësimin në Kukës për shkak të kushteve të kësaj shkolle), Ndërhyrje në shkollën Elmaz Ademi, Ndërhyrje në kopshtin e fshatit Gjegan, Ndërhyrje në shkollën e fshatit Breg-Lumë, shkolla në Surroj është mbyllur për shkak të kushteve tepër të këqija.

3.Menaxhimi i infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit: Ndërhyrje në kanalën vaditës Osmanaj, Ndërhyrje në kanalën përgjatë rrugës nacionale në fshatin Nangë, pasi është i bllokuar, Ndërhyrje në kanalën vaditës Bicaj-Nangë, Ndërhyrje në kanalën e vjetër vaditës, pastrim dhe mirëmbajtje e kanaleve vaditëse të fshatrave Malqene dhe Ujmisht,

4. Menaxhimi i mbetjeve : Menaxhim i mbetjeve urbane në fshatin Mamëz pasi djegia e tyre po shkakton dëme në mjedis (Mbeturinat në fshatin Myc-Mamëz e Kolsh nuk menaxhohen. Makineria për mbledhjen e tyre nuk shkon asnjëherë), Ndërhyrje në kanalën vaditës te Mali i Beqës për të na siguruar ujë për vaditje,

5.Shërbimet Publike Vendore: Ndriçimi në qendër të ish-komunës Ujmisht ku janë 3 institucione shërbimi për banorët (përfshirë dhe ambulancën), Rrethimi i varrezave të fshatit Gjegje, ndriçimi në fshatrat e njësisë administrative Shtiqën, ndërhyrje në godinën e njësisë administrative Shtiqën (godina ka nevojë për investim).

6. Mbështetje për zhvillim ekonomik: Mundësi për promovimin e turizmit (Kolsh, Surroj) pasi janë fshatra me resurse natyrore që duhet të shfrytëzohen (plazh, kampingje verore).

FUNKSIONE TË TJERA (QEVERISJE VENDORE + QEVERISJE QENDRORE)

1.Furnizimi me ujë dhe kanalizimet (Përgjegjësi e vetë pushtetit vendor): Ndërhyrje në ujësjellës në fshatin Gjegje pasi është i dëmtuar, ujësjellës për Qendrën Shëndetësore Lusën, ndërhyrje në depon e ujit të fshatit Bicaç pasi është e amortizuar, ndërhyrje në furnizimin me ujë në fshatin Mholaj ku është lidhur një tubacion i cili nuk është vënë në punë, sistemimi i ujërave të zeza në fshatin Bushat, kanalizimet në fshatin Novosej, ndërhyrje në ujësjellës-kanalizime në Zapod, ndërhyrje në ujësjellës në Malzi, furnizim me ujë në fshatin Kolsh, kanalizimet dhesistemimi i ujërave të zeza në fshatin Gjalicë (emergjente), ndërhyrje në sistemimin e ujërave të zeza në fshatin Shtiqën, ndërhyrje në rrjetin ujësjellës në Shtiqën, mbikëqyrje e punimeve që po bëhen nga firma private për Ujësjellësin e Kukësit e cila ka shkaktuar shumë shqetësime te qytetarët (Kukës).

2.Furnizimi me energji elektrike:

Problematika në furnizimin me energji elektrike në Arrën (nuk ka kabinë elektrike),

Kolsh -është instaluar një transformator por nuk është vënë në punë

-nuk është ndërruar as tel, asgjë (mjafton të fryjë një erë e banorët janë pa drita)

Myc-Mamëz: Lagjia Oruç dhe Lagjia Istref kanë rrjetin elektrik të lidhur me qytetin. Të bëhet edhe për lagjen Spahia, pasi kemi shumë probleme me furnizimin me energji elektrike).

3.Shëndetësia:

Rikonstrukcion i Qendrës Shëndetësore të Fshatit Kolsh pasi godina është gati duke u shembur.

Ambulanca në fshatin Kodër-Lumë është e mbyllur për shkak të kushteve.

EMERGJENTE

Riparimi i urave në fshatin Novosej. Për shkak të dëmtimit të urës është pezulluar transporti i nxënësve (20 fëmijë). Lëvizja e tyre në këmbë në këto kushte përbën rrezik emergjent për jetën. Të ndërhyhet sa më shpejt të jetë e mundur.

Sekretari i Këshillit

Kryetari i Këshillit